




DEMOCRACYPLUS

Niveli i publikimit të kontratave në prokurim publik

(Kamenicë, Podujevë, Fushë Kosovë, Shtime dhe Obiliq)



Niveli i publikimit të kontratave në prokurim publik

(Kamenicë, Podujevë, Fushë Kosovë, Shtime dhe Obiliq)

Periudha e monitorimit 1 janar – 31 tetor 2019

E drejta e autorit © 2020. Demokraci Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

"Ky botim është prodhuar me përkrahjen e Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Demokraci Plus dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Europian apo të Lidërsipit të Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet - SELDI"

Përmbajtja

Hyrje	1
Metodologjia	2
Niveli i publikimit të kontratave	3
Komuna e Kamenicës	3
Komuna e Podujevës.....	5
Komuna e Fushë Kosovës	7
Komuna e Shtimes.....	8
Komuna e Obiliqit.....	11
Konkluzione	13
Rekomandime	15

Hyrje

Në gusht të vitit 2018 prokurimi publik në Kosovë pësoi një ndryshim të madh. Disa komuna vendosën që ti publikojnë në uebfaqet e tyre kontratat e nënshkuara përmes prokurimit publik. Në muajin shtator Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) vendosi që të gjitha kontratat duhet të publikohen në platformën e e-Prokurimi¹. Për tu cilësuar një kontratë si e publikuar duhet të përmbajë kontratën, kushtet e përgjithshme të kontratës, kushtet e veçanta dhe listën e çmimeve. Lista e çmimeve është pjesa më e rëndësishme pasi në të janë të dhëna çmimet e kompanisë që ka fituar kontratën për produktet/shërbimet e kërkuara nga autoritetet kontraktuese.

KRPP nuk ka obliguar autoritetet kontraktuese që kontratën ta publikojnë edhe në uebfaqet e tyre, por në mënyrë që të rritet transparencja shumë komuna janë zotuar që do ti publikojnë kontratat në uebfaqet e tyre, mirëpo KRPP nxit autoritetet kontraktuese që ti publikojnë në uebfaqe njoftimet për kontratë dhe njoftimet për dhënie të kontratës.

Platforma e e-Prokurimit kërkon nga përdoruesit që së pari të regjistrohen në mënyrë që të mund të shkarkojnë dokumentet e tenderit, ndër to edhe kontratat. Për një përdorues që nuk ka shumë njohuri në fushën e prokurimit por dëshiron ti shikojë kontratat, nevoja për regjistrim është një pengesë e cila i dekurajon përdoruesit. Prandaj autoritetet kontraktuese, edhe pse jo të obliguar, kanë vendosur që kontratat ti publikojnë në uebfaqet e tyre si shenjë të qeverisjes së mirë.

Raporti mat nivelin e publikimit të kontratave në platformën e e-Prokurimit si dhe në uebfaqe të komunave duke përfshirë dallimin në ditë në mes të nënshkrimit të kontratës dhe publikimit, a i ka të gjitha elementet kontrata e publikuar, si dhe në çfarë formati është publikuar.

¹ A01 Ndryshim/Plotësim i Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik. Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik. 2018
<https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/2018/08/RUOPP3092018.pdf>

Metodologjia

Demokrasi Plus (D+) ka monitoruar publikimin e kontratave për pesë Komuna (Obiliq, Shtime, Fushë Kosovë, Kamenicë dhe Podujevë). D+ ka monitoruar të gjitha kontratat e nënshkruara nga 1 janar deri më 31 tetor 2019. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) nuk parasheh se sa ditë ka kohë autoriteti kontraktues të publikojë kontratën pas nënshkrimit të saj. Neni 22.3f i RRUOPP thotë që pas nënshkrimit të kontratës autoriteti ka kohë dy ditë për të publikuar njoftimin për nënshkrimin e kontratës. Pasi ky njoftim tregon që kontrata është nënshkruar për qëllim të këtij monitorimi është marrë afati dy ditë për të publikuar kontratën e nënshkruar.

D+ ka identifikuar të gjitha kontratat e nënshkruara përmes platformës e-Prokurimi, qoftë përmes shkarkimit të kontratës dhe në rastet kur nuk ka pasur kontratë të publikuar, përmes njoftimit për nënshkrim të kontratës. Po ashtu janë krahasuar kontratat e publikuara në e-Prokurim dhe në uebfaqet e komunave. Kontrata e nënshkruar për çdo lot të një tenderi janë llogaritur si një kontratë dhe si rezultat në disa raste mund të ketë një aktivitet të prokurimit që rezulton me disa kontrate. Të gjitha kontratat janë shkarkuar nga të dy uebfaqet për të parë a i kanë të gjitha elementet (kushtet e përgjithshme, kushtet e veçanta dhe listën e çmimeve). Nëse një kontratë i mungojnë kushtet e veçanta ose lista e çmimeve atëherë nuk llogaritet si e publikuar. Përveç kësaj është llogaritur dallimi në ditë në mes të datës së nënshkrimit të kontratës dhe datës së publikimit në e-Prokurim dhe në uebfaqe të komunave. Nëse dallimi është më tepër se dy ditë pune atëherë nuk llogaritet që komuna ka qenë transparente.

Kontratat me vlerë nën 1,000 euro që quhen kontrata me vlerë minimale nuk janë llogaritur pasi KRPP ende nuk ka vendosur që procedurat për këto kontrata të zhvillohen përmes e-Prokurimit. Këto procedura zhvillohen përmes faqes së vjetër të KRPP-së dhe aty publikohen njoftimet për dhënie të kontratës. Pasi nuk është obligim ligjor të publikohen këto kontrata, as komunat nuk i publikojnë në uebfaqe të tyre. Në raport, termi kontrata të nënshkruara nënkupton kontratat e nënshkruara me vlerë mbi 1,000 euro.

Niveli i publikimit të kontratave

Komuna e Kamenicës

Komuna e Kamenicës, në periudhën janar – tetor 2019, ka nënshkruar 44 kontrata. Prej tyre në platformën e-Prokurimi janë publikuar 41, ndërsa për tri aktivitete të prokurimit nuk janë publikuar ato. Dallimi në mes të datës së nënshkrimit të kontratës dhe datës së publikimit në e-Prokurim është mesatarisht 2.22 ditë që është pothuajse brenda dy ditëve të llogaritura si afat ligjor. Mirëpo, mesataren e kanë zbritur disa kontrata që janë publikuar në ditën e nënshkrimit, pasi disa kanë vonesa deri në shtatë ditë. Nga 41 kontratat e publikuara, 13 prej tyre kanë tejkaluar afatin prej dy ditësh.

Në anën tjetër, publikimi i kontratave në uebfaqe ka dallim shumë më të madh krahasuar me e-Prokurim. Pasi që publikimi në uebfaqe nuk është obligim ligjor, komuna prej 44 kontratave të nënshkruara ka publikuar vetëm 20 në uebfaqe, ku disa prej tyre janë publikuar me shumë ditë vonesë. Përderisa publikimi i nënshkrimit të kontratës në e-Prokurim ka zgjatur mesatarisht, 2.22 ditë, e njëjta në uebfaqe është zgjatur në mesatarisht 41.3 ditë. Në disa kontrata afati për zbatimin e kontratës ka qenë më i ulët se 41.3 ditë, duke ja humbur kuptimin rëndësisë së publikimit të kontratës, pasi që aktiviteti i prokurimit tashmë kishte përfunduar.

Komuna gjithashtu publikimin e kontratave e bën si fotografi të skenuar gjë që nuk të jep mundësi të kërlesh dhe kopjosh tekstin e kontratës. Kjo kryesisht ndodh për arsye se kontrata printohet në mënyrë që të nënshkruhet, e pastaj skenohet për tu publikuar në e-Prokurim dhe uebfaqe. Mirëpo një proces i tillë ua vështirëson shumë punën palëve të interesuara për të analizuar përmbajtjen e kontratës.

Dallimi në mes datës së nënshkrimit dhe datës së publikimit (në ditë)




Figura 1: Dallimi në ditë në mes të nënshkrimit të kontratës dhe publikimit të saj në e-Prokurim dhe uebfaqe në komunën e Kamenicës

Komuna e Kamenicës - Niveli i publikimit të kontratave




Figura 2: Niveli i publikimit të kontratave në e-Prokurim dhe uebfaqe për komunën e Kamenicës

Komuna e Podujevës

Komuna e Podujevës, në periudhën janar – tetor 2019, ka nënshkruar 96 kontrata. Në e-Prokurim janë publikuar 84 kontrata, në 65 prej të cilave mungon lista e çmimeve që është elementi kryesor i një kontrate. Edhe para vendimit të KRPP-së për hapje të kontratave, fituesi i tenderit dhe çmimi është ditur përmes njoftimit për dhënie/nënshkrim të kontratës, por nuk janë ditur çmimet e dhëna për secilin produkt apo shërbim. Pa këtë element mund të thuhet që një kontratë e publikuar nuk iu shërben palëve të interesuara. Në anën tjetër, me mos publikimin në e-Prokurim të 12 kontratave, komuna e Podujevës ka shkelur në tërësi udhëzuesin e KRPP-së për publikimin e kontratave.

Nga kontratat që janë publikuar në e-Prokurim koha mesatare në mes të datës së nënshkrimit të kontratës dhe datës së publikimit është 3.27 ditë, pra më e lartë se në komunën e Kamenicës. 51 kontrata janë publikuar brenda dy ditëve nga nënshkrimi i kontratës, ndërsa 33 tjera janë publikuar, mesatarisht, pas më shumë se dy ditësh. Sikurse në Kamenicë, edhe në Podujevë janë disa kontrata që janë publikuar me vonesë të madhe dhe pasi janë përfunduar punët. E tillë është kontrata "Heqja e bazamenteve (themeleve shiritore dhe pllakës nga betonarmeja) të kontejnerëve në

lagjen e dëshmorëve dhe largimi i tyre në deponinë më të afërt”, e cila ka pasur të përfundojë brenda tetë ditësh, por është publikuar 41 ditë pasi është nënshkruar.

Në uebfaqe janë publikuar 67 kontrata, ndërsa 29 nuk janë publikuar. Sikurse në e-Prokurim, edhe këtu 52 kontratave të publikuara iu mungon lista e çmimeve, prandaj të publikuara llogariten vetëm 15 kontrata (67-52). Gjithashtu, njëjtë sikurse në komunën e Kamenicës kontratat publikohen si dokument i skenuar i ruajtur si fotografi, i cili nuk të jep mundësi të kërlesh dhe kopjosh tekstin e kontratës. Publikimi në uebfaqe bëhet më shpejtë se në komunën e Kamenicës, mesatarisht kontratat publikohen pas 4.44 ditëve që është afër mesatares së publikimit në e-Prokurim. Zakonisht komuna publikon kontratat në e-Prokurim dhe në uebfaqe në të njëjtën ditë, që edhe do të duhej të ndodhte kështu.




Figura 3: Dallimi në ditë në mes të nënshkrimit të kontratës dhe publikimit të saj në e-Prokurim dhe uebfaqe në komunën e Podujevës

Komuna e Podujevës - Niveli i publikimit të kontratave




Figura 4: Niveli i publikimit të kontratave në e-Prokurim dhe uebfaqe për komunën e Podujevës

Komuna e Fushë Kosovës

Gjatë periudhës janar – tetor 2019, komuna e Fushë Kosovës ka nënshkruar 77 kontrata, prej tyre të publikuara në e-Prokurim janë 73, ndërsa katër nuk janë publikuar. Komuna e Fushë Kosovës ka të përfshirë në kontratë edhe listën e çmimeve, për dallim nga komuna e Podujevës. Vetëm një kontratë nuk e ka listën e çmimeve, tenderi "Mbushja-riparimi i gropave me asfalt".

Koha mesatare e publikimit të kontratës pas nënshkrimit të saj është 1.25 ditë, mesatare e cila është më e mira nga të gjitha komunat. Për dallim prej komunave tjera, është vërejtur që në përgjithësi Fushë Kosova i publikon kontratat në e-Prokurim në ditën e nënshkrimit të tyre. Kjo praktikë e mirë do të duhej të ndiqej nga të gjitha komunat në mënyrë që mos të kemi dallime në mes të ditëve kur nënshkruhet kontrata dhe kur publikohet ajo. Vetëm 13 nga 77 kontrata kanë më shumë se dy ditë dallim në mes të datës së nënshkrimit dhe asaj të publikimit.

Efikasiteti i publikimit të kontratave në e-Prokurim, nuk është reflektuar edhe në publikim të tyre në uebfaqe të komunës. Vetëm 33 nga 77 kontratat e nënshkruara

janë të publikuara në uebfaqe. Komuna nuk ka publikuar kontratë në uebfaqe që nga 2 shtatori 2019. Të gjitha kontratat e publikuara, duket që janë publikuar në ditën e nënshkrimit. Megjithatë, D+ ka gjetur që komuna ka ndërruar datën e publikimit, pasi që në të vërtetë të gjitha kontratat e publikuara nga muaji prill janë publikuar në shtator 2019. Manipulimi i datës së publikimit, vë në hije të gjitha përpjekjet për transparencë në prokurim publik, sepse vë në dyshim komplet procesin e prokurimit.

Si pasojë e të dhënave jo të vërteta nga publikimi i kontratave në uebfaqe për komunën e Fushë Kosovës nuk është paraqitur grafikoni për të krahasuar dallimin në ditë në mes të publikimit të kontratave në e-Prokurim dhe uebfaqe.




Figura 5: Niveli i publikimit të kontratave në e-Prokurim dhe uebfaqe për komunën e Fushë Kosovës

Komuna e Shtimes

Komuna e Shtimes, edhe pse më e vogla nga katër komunat tjera, ka nënshkruar 71 kontrata nga janari deri më tetor 2019. Prej tyre 62 janë të publikuara në e-Prokurim, ndërsa nëntë nuk janë të publikuara. Edhe kjo komunë sikur komunat tjera nuk e ka

përmbushur obligimin ligjor në tërësi. Pesë (5) prej 9 kontratave të papublikuara janë aneks kontrata të kontratave të mëparshme. Dallimi në ditë në mes të nënshkrimit dhe publikimit të kontratës në e-Prokurim është 1.73 ditë, e cila nënkupton që kontratat publikohen në e-Prokurim brenda një kohe të arsyeshme. Shumica e kontratave janë publikuar në ditën e nënshkrimit ose ditën e nesërme mirëpo janë dy kontrata që janë publikuar 33, përkatësisht 40 ditë pas nënshkrimit.

Sa i përket publikimit të kontratave në uebfaqe komuna nuk ka qenë transparente, pasi ka publikuar vetëm 15 kontrata, ndërsa 56 nuk janë publikuar. Nga kontratat që janë publikuar, nëntë prej tyre nuk e kanë të shkruar titullin e kontratës në vegëzën lidhëse (linku), pra duhet që të hapen të gjitha një nga një për të parë emrin e kontratës, e në këtë rast pra as nuk mund të kërkojë një kontratë specifike përmes fjalëve kyçe. Kontrata mund të ekzistojë në uebfaqe por përmes kërkimit nuk mund ta gjejsh, pasi që emrat e dokumentit në uebfaqe i ka bërë me titull "Kontrata", "Kontrata (3)" e kështu me radhë.

Numri i vogël i kontratave të publikuara në uebfaqe, bënë që dallimi në ditë në mes të nënshkrimit të kontratës dhe publikimit në mesatare të jetë vetëm 0.8 ditë. Kjo tregon që komuna e Shtimes në shumicën e raste ka neglizhuar në tërësi publikimin e kontratave në uebfaqe, përderisa ato që ka vendosur t'i publikoj, i ka publikuar pothuajse brenda ditës.

Dallimi në mes datës së nënshkrimit dhe datës së publikimit (në ditë)




Figura 6: Dallimi në ditë në mes të nënshkrimit të kontratës dhe publikimit të saj në e-Prokurim dhe uebfaqe në komunën e Shtimes

Komuna e Shtimes - Niveli i publikimit të kontratave




Figura 7: Niveli i publikimit të kontratave në e-Prokurim dhe uebfaqe për komunën e Shtimes

Komuna e Obiliqit

Nga 1 janari 2019 e deri më 31 tetor, komuna e Obiliqit ka nënshkruar 73 kontrata. Prej tyre, 40 janë publikuar, përderisa 33 të tjera nuk janë publikuar. Nga 40 kontratat e publikuara, mesatarja e publikimit është 2.76 ditë pasi është nënshkruar kontrata, kohë e cila tejkalon afatin prej dy ditëve. 20 nga 40 kontrata janë publikuar brenda afatit kohor prej dy ditësh. Dy kontrata nuk e kanë të përfshirë listën e çmimeve dhe nuk mund të konsiderohen si të publikuara, pasi informatat tjera që janë në kontratë siç janë fituesi dhe çmimi i kontratës mund të gjenden në njoftimin për nënshkrim të kontratës.

Sikurse edhe tek komunat tjera, edhe në Obiliq, kontratat publikohen si një dokument i skenuar, i cili nuk jep mundësi të kërkimit brenda tekstit.

Komuna e Obiliqit ka publikuar 49 kontrata në uebfaqe, ndërsa 24 nuk i ka publikuar. Edhe në këtë komunë, si në atë të Fushë Kosovës është shfaqur dukuria e ndërrimit të datës së publikimit, duke bërë që publikimi të duket sikur ka ndodhur në ditën e nënshkrimit. Komuna ka ndërruar datat për disa muaj, shembull kontratat e muajit prill 2019 i ka publikuar në fakt në maj 2019, ato të majit, qershorit,

korrikut dhe gushtit në shtator. Nga ajo çfarë ka gjetur D+, duket që të gjitha kontratat janë publikuar në një ditë të vetme, gjë që e lëkund besimin në sinqeritetin e institucioneve në të gjithë procesin e transparencës në prokurim publik.

Problem tjetër është edhe emërtimi i tyre në uebfaqe, të gjitha janë me emër "kontrata 001", "kontrata 002" e kështu me radhë. Kjo mënyrë e emërimit e pamundëson kërkimin në uebfaqe me emër të kontratës. Gjatë procesit të përgatitjes së këtij raporti, hulumtuesit e D+ për të verifikuar se cilat kontrata janë të publikuara në uebfaqe, është dashur që të hapen të gjitha një nga një dhe të shikohen nëse ato përputhen me kontratat/njoftimet për nënshkrim të kontratës në e-Prokurim, pasi siç është përmendur më lartë teksti nuk mund të kopjohet brenda kontratës.

Sikurse për komunën e Fushë Kosovës, edhe për Obiliq, si pasojë e të dhënave jo të vërteta nga publikimi i kontratave në uebfaqe, nuk është paraqitur grafikoni për të krahasuar dallimin në ditë në mes të publikimit të kontratave në e-Prokurim dhe uebfaqe.




Figura 8: Niveli i publikimit të kontratave në e-Prokurim dhe uebfaqe për komunën e Shtimes

Konkluzione

Në përgjithësi niveli i publikimit të kontratave në e-Prokurim është në nivel të lartë. Komuna e Kamenicës dhe Fushë Kosovës kanë përqindjen më të lartë të publikimit me 93% dhe 95%. Komuna e Shtimes qëndron pak më keq me 85%. Komuna e Obiliqit ka pak më shumë se gjysmën e kontratave të publikuara, 55%. Komuna e Podujevës për shkak të numrit të madh të kontratave të publikuara pa listë të çmimeve, gjithsej 65 kontrata, e ka nivelin shumë të ulët të publikimit, rreth 20%.




Figura 9: Numri i kontratave të publikuara dhe të pa publikuara në e-Prokurim për pesë komunitat

Publikimi në uebfaqe pasi nuk është i obliguar me ligj transparenca është më e ulët. Komuna e Fushë Kosovës dhe Obiliqit kanë ndryshuar datat e publikimit dhe ky manipulim me të dhëna nuk mund të quhet transparenca dhe për këtë arsye nuk janë përfshirë në grafikën më lartë. Komuna e Kamenicës ka nivelin më të lartë të

publikimit, 45%, por me vonesën më të madhe në ditë. Komuna e Shtimes qëndron pak më dobët me 21% të kontratave të publikuara, por në uebfaqe i publikon shumë shpejtë, kryesisht në ditën e nënshkrimit. Ndërsa komuna e Podujevës edhe në uebfaqe kontratat i ka shumicën pa listë të çmimeve të cilat nuk janë llogaritur si kontratë e publikuar, e si pasojë niveli i publikimit është shumë i ulët, vetëm 15%.




Figura 10: Numri i kontratave të publikuara dhe të pa publikuara në uebfaqe për pesë komunat

Kontratat e pa publikuara, ato që janë të publikuara më shumë vonesë si dhe ndryshimet e datave të publikimit në dy komuna mund të ju atribuohen mungesës së komunikimit në mes të zyrës së prokurimit që ka për detyrë të dërgojë kontratat te zyra e teknologjisë informative e cila menaxhon uebfaqen e komunës. Mirëpo publikimi në e-Prokurim është përgjegjësi e zyrës së prokurimit pasi kjo zyrë publikon të gjitha dokumentet tjera në platformë (njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit, etj).

Rekomandime

- Të gjitha komunat duhet që të sigurohen që të publikojnë të gjitha kontratat në e-Prokurim dhe në uebfaqe brenda dy ditëve nga nënshkrimi.
- Komunat duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi publikimit në uebfaqe, në mënyrë që mos të ketë dallime në mes të këtyre dy platformave.
- Komuna e Shtimes dhe Obiliqit duhet që t'i emërtojnë kontratat në uebfaqe me emrin e aktivitetit të prokurimit. Në e-Prokurim mund të kërkohet me emër të tenderit dhe elemente tjera, por në uebfaqe nevojitet emri i saktë në mënyrë që të mund të kërkohet.
- Komuna e Podujevës duhet që të përfshijë në kontratë edhe listën e çmimeve, pasi pa këtë element kontrata e publikuar nuk ka vlerë për palën e interesuar si dhe është obligim ligjor.
- Komuna e Kamenicës duhet që kontratat në uebfaqe t'i publikojë më shpejt pasi në disa raste kontrata veçse kishte përfunduar në kohën kur është publikuar.

Demokrasi Plus (D+) është një organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimi në proceset e vendimmarrjes. Ne tentojmë integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet tona, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie.

D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore.

Përkrahur nga:

